



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PRRENJAS

Prrenjas, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “Ndertime, rikonstruksione lerash uji per bagetite dhe sistemime malore (prita malore)” e ndare ne lote: **Loti 1** Prita me mure guri të thatë, llac, cemento e brez betoni, fshati Bërzeshtë; **Loti 2** Rehabilitim Lere Plasmasi, Prrenjas Fshat; **Loti 3** Rehabilitim Lere Plasmasi, fshati Pishkash Veri; **Loti 4** Rehabilitim Lere Plasmasi, fshati Katjel”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Kodi CPV: **Punime ndertimi per prita statike 45247240-4**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

“Ndertime, rikonstruksione lerash uji per bagetite dhe sistemime malore (prita malore)” e ndare ne lote me fond limit total prej **4,175,761** (kater milion e njeqind e shtatedhete e pese mije e shtateqind e gjashtedhete e nje) **lekë pa TVSH** dhe **5,010,914** (pesë milion e dhjetë mijë e nenteqind e katermbedhete) **lekë me TVSH**.

**Loti 1 Prita me mure guri të thatë, llac, cemento e brez betoni, fshati Bërzeshtë** me fond limit **1,104,284** (nje milion e njëqind e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër ) **leke pa TVSH** dhe **1.325.141**(nje milion e treqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e dyzet e një ) **leke me tvsh**;

**Loti 2 Rehabilitim Lere Plasmasi, Prrenjas Fshat** me fond limit **791.215** (shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) **leke pa TVSH** dhe **949.458** (nëntëqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë ) **lekë me TVSH**.

**Loti 3 Rehabilitim Lere Plasmasi, fshati Pishkash Veri** me fond limit **1.105.938** (nje milion e njëqind e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë ) **leke pa TVSH** dhe **1.327.126** (një milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e njëqind e njëzet e gjashtë ) **lekë me TVSH**.

**Loti 4 Rehabilitim Lere Plasmasi, fshati Katjel** me fond limit **1.174.324** (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e njëzet e kater) **leke pa TVSH dhe 1.409.189** (një milion e katerqind e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e nëntë ) **lekë me TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Prrenjas ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Loti 1 Prita me mure guri të thatë, llac, cemento e brez betoni, fshati Bërzeshtë**  
**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formularin e Ofertes sipas Shtojcës 1.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbështetje te Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 29 dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori.

**Shënim\*:** Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilin ofertohej, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” .

**Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.**

**Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur në zbatim të nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pasi kjo procedure prokurimi është nën kufirin e ulët monetar.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

---

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *“Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e

vleres se fondit limit dhe vendosja e ketij limiti nuk kufizon pjesemarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 date 19.05.2008 ”Per Procedurat Tatimore” , neni 64 ”Deklarata Tatimore”

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020,2021, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin

deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera e fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

1. Formularin e vleresimit;
2. Kontratën/Kontratën;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikatën/certifikatat e marrjes në dorezim;
6. Faturat tatimore;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Fatura tatimore

**Shënim\*:** Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 30% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilën ofertohej.

**Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4.. *ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të*

*zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontrata e zbatuara ne te shkuaren dhe nenit 55, pika 4, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik"...Lidhur me kerkesat per pervojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:a) Për kontratat e punëve:*

*i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që ështërealizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat jo me te madhe se 30 % e vleres së fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori, për një objekt të vetëm, ose vlera e fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori., për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nen kufirin e ulet monetar, punët e mëparshme të ngjashme jane minimalisht në vlerat jo me te madhe se 30% % të vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori, për një objekt të vetëm, ose vlera e fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim te konkurrences.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",neni 39,pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit" (i ndryshuar), Udhezimi i K.M nr.2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve te

ndërtimit”, Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 ”Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit “ te ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për te vertetuar kerkesat e percaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9, kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim për punët e kryera me entet publike, qe Autoriteti Kontraktor te bindet qe operatori ekonomik me ane te dokumentacionit te paraqitur ploteson kriterin për punë te ngjashme ku shihen zerrat e punimeve qe ka realizuar, koha e realizimit, dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes ne dorezim te objektit si dhe vleresimi i dhene nga Autoriteti Kontraktor, elemente te nevojshem për te gjykuar për plotesimin e kriterëve për punë te ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1. Inxhinier 1 (nje)

a. Operatori Ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin e meposhtem për inxhinierin e kerkuar:

- Diploma profesionale.
- Kontrate pune e vlefshme gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate.
- Të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se tenderit.

***Sqarim për operatorët ekonomike : Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues, bazuar në nenin 82 të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “ Për Prokurimin Publik ” dhe nenit 26, 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” .***

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshtë kërkuar inxhinier për kontrollin dhe zbatimin e punimeve në përputhje me zerrat e punimeve të preventivit, projektit, specifikimeve teknike

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 3 (tre) punonjes** për muajin e fundit nga data e hapjes se tenderit.

Operatori Ekonomik fitues duhet te dorezoje dokumentacionin:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku te specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, te paraqitura dhe te konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

**Sqarim per operatoret ekonomike : Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues, bazuar ne nenin 82 te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Për Prokurimin Publik ” dhe nenit 26, 39 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” .**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Numri i punonjesve eshte vendosur bazuar ne preventiv. Per shkak te efekteve te punimeve ne mjedis dhe per te mbrojtur mjedisin nga demtimet e mundshme, shumica derrmuese e punimeve do te kryhen me krahe dhe duhen minimalisht 3 (tre) punetore per kryerjen e punimeve brenda afatit kohor te percaktuar.*

Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kerkese eshte e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

#### 4. Operatori ekonomik duhet te disponoje

1.OHSAS ISO 45001-2018 mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë”/ekuivalente dhe e vlefshme

2. ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambjentit”/ ekuivalente dhe e vlefshme

**Te gjitha certifikatat e mesiperme duhet te jene te lëshuara** nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

**Argumentimi:** Eshte vendosur ky kriter në përputhje me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 77, pika 4, VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“, neni 44,si dhe natyrës së punimeve që do realizohen. Keto certifikata jane te lidhura me natyren dhe zerat e punimeve qe do te realizohen.



Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikat **ISO 14001:2015 mbi** “Sistemet e menaxhimit të ambientit” , është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të ambientit .

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikatën **ISO OHSAS 18001:2007** Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune ose te disponojnë certifikatën me standartin e azhornuar dhe ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare **ISO 45001-2018**, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem per menaxhimin e shendetit dhe sigurise ne pune

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **Loti 2 Rehabilitim Lere Plasmasi, Prrrenjas Fshat**

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formularin e Ofertes sipas Shtojcës 1.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 29 dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020,2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurren operatori.

**Shënim\*:** Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilin ofertohe, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” .

**Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.**

**Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur ne zbatim te nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pasi kjo procedure prokurimi eshte nen kufirin e ulet monetar.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

---

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *”Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:c) 40 % të vlerës së*

parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 date 19.05.2008 ”Per Procedurat Tatimore” , neni 64 ”Deklarata Tatimore”

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020,2021, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera e fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

1. Formularin e vleresimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikaten/certifikatat e marrjes në dorezim;
6. Faturat tatimore;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Fatura tatimore

**Shënim\*:** Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 30% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilin ofertohej.

**Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4. *ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vertetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”...Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:*

*i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat jo më të madhe se 30 % e vlerës së fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori, për një objekt të vetëm, ose vlera e fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori., për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar, punët e mëparshme të ngjashme janë minimalisht në vlerat jo më të madhe se 30% % të vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori, për një objekt të vetëm, ose vlera e fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të

realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

**Te gjitha certifikatat e mesiperme duhet te jene te lëshuara** nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi:** Eshtë vendosur ky kriter në përputhje me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 77, pika 4, VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“, neni 44,si dhe natyrës së punimeve që do realizohen. Keto certifikata janë të lidhura me natyrën dhe zerat e punimeve që do të realizohen.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikat **ISO 14001:2015 mbi** “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” , është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të mjedisit. Disponimi i ISO 14001:2015 siguron faktin që operatorit ekonomik menaxhon në mënyrë sistematike aspektet specifike mjedisore të të gjithë aktiviteteve, me qëllim të promovimit të mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimit mjedisor të proceseve prodhuese.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikatën OHSAS **ISO 45001-2018** Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune ose te disponojnë certifikatën me standartin e azhornuar dhe ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare **ISO 45001-2018**, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem per menaxhimin e shendetit dhe sigurise ne pune.

ISO 45001 është projektuar për të parandaluar aksidentet dhe sëmundjet në punë dhe për të siguruar ambiente të sigurta dhe të shëndetshme të punës. Për organizatat që veprojnë ose tregtojnë në nivel ndërkombëtar, duke punuar me një standard të vetëm ndërkombëtar që tejkalon kufijtë gjeografikë, politikë, ekonomikë, komercialë dhe socialë, mund të lehtësojë punën tuaj. Qëllimi kryesor i standardit ISO 45001 është të minimizojë problemet e sigurisë në vendin e punës, të eliminojë këto rreziqe, të sigurojë respektimin e ndërmarrjes, të tregojë përgjegjësinë e kompanise dhe të mbajë motivimin e punonjësve, asetet më të vlefshme për ndërmarrjen.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

#### **Loti 4** Rehabilitim Lere Plasmasi, fshati Katjel

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e Ofertes sipas Shtojces 1.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 29 dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

---

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vleres së fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori.

*Shënim\*:* Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilën ofertohe, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave”.

*Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.*

*Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur ne zbatim te nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pasi kjo procedure prokurimi eshte nen kufirin e ulet monetar.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

---

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *“Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”*”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore", neni 64 "Deklarata Tatimore"

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2018, 2019,2020, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera e fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

1. Formularin e vleresimit;
2. Kontratën/Kontratata;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikaten/certifikatat e marrjes në dorezim;
6. Faturat tatimore;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Aktkolaudim i objekti;
4. Fatura tatimore

**Shënim\*:** Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 30% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/lotëve për të cilin ofertohej.

**Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4.. *ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësor. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”...Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:a) Për kontratat e punëve:*

*i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat jo më të madhe se 30 % e vlerës së fondit limit\* të lotit apo shumës

**së loteve për të cilat konkurron operatori**, për një objekt të vetëm, ose **vlera e fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori.**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar, punët e mëparshme të ngjashme janë minimalisht në vlerat jo më të madhe se 30 % të vlerës së fondit limit **të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori**, për një objekt të vetëm, ose **vlera e fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), Udhezimi i K.M nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 “Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vertetuar kërkesat e përcaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9, kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim për punët e kryera me entet publike, që Autoriteti Kontraktor të bindet që operatori ekonomik me anë të dokumentacionit të paraqitur plotëson kriterin për punë të ngjashme ku shihen zerrat e punimeve që ka realizuar, koha e realizimit, dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes në dorezim të objektit si dhe vleresimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktor, elemente të nevojshme për të gjykuar për plotësimin e kriterëve për punë të ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.



2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1. Inxhinier 1 (nje)

a. Operatori Ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin e meposhtem per inxhinierin e kerkuar:

- Diploma profesionale.
- Kontrate pune e vlefshme gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate.
- Të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se tenderit.

***Sqarim per operatoret ekonomike : Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues, bazuar ne nenin 82 te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Për Prokurimin Publik ” dhe nenit 26, 39 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” .***

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” ne nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe ne vkm Nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” e ndryshuar.

Eshtë kërkuar inxhinieri për kontrollin dhe zbatimin e punimeve ne perputhje me zerat e punimeve te preventivit, projektit, specifikimeve teknike, ndaj dhe eshte e nevojshme prania e nje inxhinieri per te ndjekur punimet.

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 3 (tre) punonjes** për muajin e fundit nga data e hapjes se tenderit.

Operatori Ekonomik fitues duhet te dorezoje dokumentacionin:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku te specifikohet numri i punonjësve per muajin e fundit nga data e hapjes se tenderit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, te paraqitura dhe te konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

***Sqarim per operatoret ekonomike : Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues, bazuar ne nenin 82 te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Për Prokurimin Publik ” dhe nenit 26, 39 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” .***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Numri i punonjesve eshte vendosur bazuar ne preventiv, pasi ne zerin e preventivit eshte shenuar:* nr.2 Analize, Prishje me krahe shtrese kalldremi me trashesi 20 cm; Nr.3 Analize, Transport guri me tezge 20 ml nga prishja e kalldremit; Nr.5 Analize 3.48/b Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne germim toke te zakonshme; nr.6 analize Shtrim plasmasi me 2 shtresa; nr.7 Analize Shoshje dheu per shtrim plasmasi; Nr.8 analize Transport dheu me tezge 20 ml (2 punetore); nr 10 analize, Transport guresh me tezge per berjen e kalldremit, distance deri 20 ml; si dhe zera te tjere ne preventiv per kryerjen e te cilave nevojitet force punetore qe punimet te kryhen ne kohe dhe cilesi.

*Per shkak te efekteve te punimeve ne mjedis dhe per te mbrojtur mjedisin nga demtimet e mundshme, shumica derrmuese e punimeve do te kryhen me krahe dhe duhen minimalisht 3 (tre) punetore per kryerjen e punimeve brenda afatit kohor te percaktuar ne DST.*

Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kerkese eshte e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

4. Per te realizuar punimet, krahas stafit te mesiperm, Operatori/et ekonomik pjesemarres duhet te kete te punësuar, me kohe te plote, si me poshte:

<b>Stafi</b>	<b>Sasia</b>
Shofer	1

- Per stafin e mesiperm të paraqitet kontrate pune perkatese, Dëshmi e aftësisë profesionale e vlefshme si dhe leje drejtimi/patente.

**Sqarim per operatoret ekonomike** : *Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues, bazuar ne nenin 82 te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Për Prokurimin Publik ” dhe nenit 26, 39 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” .*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një*

*standardi të përshtatshëm cilësie” ne nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Duke gene se ne kriteret e tenderit eshte kerkuar 1 Kamion, eshte e nevojshme dhe disponimi i nje shoferi per te drejtuar mjetin e mesiperm.

5. Ofertuesi duhet te disponoje keto makineri:

Nr.	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1.	Kamion me kapacitet mbajtes 0- 3.5 ton	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
2.	Karroca dore	Cope	2	Ne pronesi ose me qira

5.1 Makinerite dhe pajisjet ne pronesi te shoqerohen me akt pronesie origjinale ose fotokopje e noterizuar.

5.2 Makinerite dhe paisjet me qira te shoqerohen me kontrata qiraje noteriale si dhe te shoqerohen me aktin e pronesise te qiradhenesit (origjinalin ose fotokopje e noterizuar).

5.3 Kontrata e qirase per makinerite ne fjale duhet te jete e shtrire brenda afatit te realizimit te punimeve qe parashikon kontrata qe prokurohet.

5.4 Per mjetet qe shenohen ne regjistrat publik duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti). Per paisjet e tjera duhet te jene aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, origjinale ose fotokopje e noterizuar.

***Sqarim per operatoret ekonomike : Dokumentacioni provues, qe OE i disponon mjetet e mësipërm, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues, bazuar ne nenin 82 te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Për Prokurimin Publik ” dhe nenit 26, 39 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” .***

**Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes.

*Kamioni eshte kerkuar bazuar ne zerat e preventivit per te transportuar materialet e renda te ndertimit, te dheut si dhe per te transportuar mbetjet e krijuara gjate punimeve, te cilat nuk mund te transportohen dot me karroca dore nga punetoret. Zerat ne preventiv per te cilat nevojitet kamioni: Nr. 2.1 analize Germim e transport dheu (shtresa poshte kalldremit) me kd 10 m, kategoria III; nr. 2.1 Germim e transport dheu (Mbeturinash) me kd 10 m, kat III; Nr.2.1. analize Germim e transport dheu (Shtresa poshte kalldremit) me kd 10 m, kat III.*

*Karrocat e dores jane kerkuar bazuar ne zerat e preventivit si dhe pasi shumica e puneve do te kryhen me dore per te mos demtuar mjedisin dhe jane te nevojshme per transportin e materialeve apo per heqjen e mbeturinave.*

6. Operatori ekonomik duhet te disponoje

1.OHSAS ISO 45001-2018 mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë”/ekuivalente dhe e vlefshme

2. ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”/ ekuivalente dhe e vlefshme

**Te gjitha certifikatat e mesiperme duhet te jene te lëshuara** nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të perkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Certifikatat duhet të jene të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi:** Eshte vendosur ky kriter në përputhje me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 77, pika 4, VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“, neni 44,si dhe natyrës së punimeve që do realizohen. Keto certifikata janë të lidhura me natyrën dhe zerat e punimeve që do të realizohen.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikat **ISO 14001:2015 mbi** “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” , është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të mjedisit. Disponimi i ISO 14001:2015 siguron faktin që operatori ekonomik menaxhon në mënyrë sistematike aspektet specifike mjedisore të të gjithë aktivitetëve, me qëllim të promovimit të mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimit mjedisor të proceseve prodhuese.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikatën OHSAS **ISO 45001-2018** Standart për Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ose të disponojnë certifikatën me standartin e azhurnuar dhe ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare **ISO 45001-2018**, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë.

ISO 45001 është projektuar për të parandaluar aksidentet dhe sëmundjet në punë dhe për të siguruar ambiente të sigurta dhe të shëndetshme të punës. Për organizatat që veprojnë ose tregtojnë në nivel ndërkombëtar, duke punuar me një standard të vetëm ndërkombëtar që tejkalon kufijtë gjeografikë, politikë, ekonomikë, komercialë dhe socialë, mund të lehtësojë punën tuaj. Qëllimi kryesor i standardit ISO 45001 është të minimizojë problemet e sigurisë në vendin e

punës, të eliminojë këto rreziqe, të sigurojë respektimin e ndërmarrjes, të tregojë përgjegjësinë e kompanise dhe të mbajë motivimin e punonjësve, asetet më të vlefshme për ndërmarrjen.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/ç dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Prrenjas, ka ngritur grupin e punës, i cili ka kryer:

- Hartimin e specifikimeve teknike;
- Përlllogaritjen e fondit limit;
- perlllogaritjen e nr te punonjesve te kerkuar ne kritere
- Përcaktimin e çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga grupi per fondin limit që ka hartuar edhe projektin përkatës të zbatimit duke qënë elementë perbërës të tij.Ne hartimin e tyre janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushes së planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligji Nr.8402, DATE 10.9.1998, PER KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TE NDERTIMIT i ndryshuar.*

*Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.*

## **Njesia e Prokurimit**